

Akt Themelimi

I shoqërise tregtare “SFERICO SPORTS MANAGMENT ALBANIA” SH.P.K.

Mbeshtetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqipërisë, në ligjin Nr.7512 datë 10.08.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lire dhe të veprimtarisë private dhe privatizimit”, të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për shoqëritë tregtare” dhe të ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Q.K.B dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare, me vullnetin e tyre të lire, të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi, Une themeluesi Z. Mehmet Qatja me nr ID J20303101D, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “SFERICO SPORTS MANAGMENT ALBANIA” SH.P.K. me akt themelimi si vijon:

Formulimi

Neni 1

Sot me datë 19.04.2022, formohet shoqëria tregtare private e quajtur “SFERICO SPORTS MANAGMENT ALBANIA” SH.P.K. Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndërsa deget që mund të krijohen do të nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë seline dega. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues.

Selia e Shoqërisë

Neni 2

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Tiranë, Kavajë, Lagja nr 02, prone në legalizim, nr 1983 protokoll, datë 19.04.2022

Objektivi i Veprimtarisë

Neni 3

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Veprimtari në fushën Menaxhimit të sportistëve.Bar kafe,piceri ,restorant dhe aktivitete të ndryshme në fushën e turizmit.

Kohezgjatja e Shoqërisë

Neni 4

Kohezgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund shperbehet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloji shkak.

Kapitali i Shoqërisë

Neni 5



1. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 lekë (njëqind mije) Lekë.1.
Ortaku themelues Z. Mehmet Qatja: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme
100.000(njëqind mije)leke, që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo
të drejta).

Drejtimi i Shoqërisë

Neni 6

Shoqëria do të drejtohet nga administratori Z. Mehmet Qatja, i cili do të jetë dhe përfaqësuesi
ligjorë i saj. Ai është përfaqësuesi i Shoqërisë në marrëdhënie me të tretet dhe kanë kompetencë të
plota në drejtimin e saj.
Cdo kontratë do të kryhet prej Tij dhe në rast mungese nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të
posaçme.

Neni 7

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakëve.

Neni 8

Ortakët kanë të drejtë të emerojnë dhe administrojnë të tjerë të vlerave materiale.
Kane të drejtë të caktojnë financiare, likuidator për problemet e shoqërisë si dhe të pajtojnë persona
të tjerë si ortakë.

Neni 9

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqiptar në Gjykatën e
Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Neni 10

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me tekstin rreth saj.

Neni 11

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me
legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe vecanerisht të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Krijimin e
Shoqërive Tregtare”, si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare dhe të vendit si dhe rregullave që
zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri.

Neni 12

Akti i themelimit u perpilua në 2 kopje, për t’ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje
do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë “SFERICO SPORTS MANAGMENT
ALBANIA” SH.P.K.

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët.

Ortaku themelues
z. Mehmet Qatja